



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1879 prot

Roskovec , më 28.04 .2020

VENDIM

NR 24 ,DATË 27.04 .2020

“PËR

DHËNIE NDIHMA USHQIMORE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR SHKAKË TË
EPIDEMISË NGA COVID-19

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore“neni 9 pika 1.4 gërma a.neni 40 pika 1,neni 54 gërma dh, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH”, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ , të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , të VKM nr. 243 , datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore" pika 6.1/2.b e tij,të relacionit të sjellë nga Shtabi i Emergjencave Civile të Bashkisë,në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 ;Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- I. Të miratohet fondi prej 500,000 lekë për dhënie e ndihma ushqimore dhe detergjent për familjet e varfëra në nevojë që përfitojnë nga vendimi nr.2 , datë 24.03.2020 të Komisionit Qëndror për Ofrimin e Asistencës, të evidentuara dhe të miratuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, sipas kriterëve të cilat janë të përcaktuara në relacionin e bashkëlidhur.
Fondi prej 500,000 lekë të përballohet nga fondi për emergjencat civile (pjesa nga buxheti i bashkisë) të aprovuar në buxhetin e vitit 2020.
- II. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike e bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Myska

